

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kryeveterani i UÇK-së kërkon dorëheqjen e Donika Gërvallës: Bashkëpunon me Vuçiç
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/18/kryeveterani-i-uck-se-kerkon-doreheqjen-e-donika-gervalle-s-bashkepunon-me-vucic/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 12:32:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 12:27:28 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ab879520103195d3495e516039193342346ad958ddf4003443f8209fa20cf0f9
TEKSTI	c24f2d50bb8f2ef7e7a9684333087f77c3053070587b9477ed5a496d3f46036c
PAMJA	e845be34c1932f0d101149fbcdbdeabeaafc14ca96d6782528ad8cfa290344ee2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f0eea151613f263f5078fd4cb48a0f2e12c3b30f41d9c19c90d56f28f8b61602
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f0eea151613f263f5078fd4cb48a0f2e12c3b30f41d9c19c90d56f28f8b61602>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > RAJONI

Kryeveterani i UÇK-së kërkon dorëheqjen e Donika Gërvallës: Bashkëpunon me Vuçiç

14:27 : 18/09/2026 në RAJONI



Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së, Hysni Guçati kërkoj dorëheqjen e ministres së Drejtësisë, Donika Gërvalla, krahas shfuqizimit të vendimit të Gjykatës Speciale për dënimin e ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke e akuzuar se bashkëpunon me Vuçiç.

Në protestën e sotme, ku u mbledhën mijëra qytetarë në sheshin "Skënderbeu" për të kundërshtuar dënimin e Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit, ai i bëri thirrje kryeministrit Albin Kurti që të distancohet edhe nga ish-deputeti dhe zyrtari i LVV-së, Liburn Aliu, meqë, sipas tij, i njëjti kishte bërë deklarata në Kuvend.

Duke kritikuar mosdeklarimin e ministres Gërvalla, për verdiktin e Speciales, ai tha se e njëjta ka dërguar dokumentacione në Hagë kundër ish-krerëve të UÇK-së.

"Ne sot kërkojmë që këtë vendim Gjykata Speciale ta shfuqizojë dhe të marrë parasysh gjithë këtë popull, mbi 2 milionë shqiptarë, që janë ngritur në këmbë për t'i mbrojtur djemtë e vet. Ne sot jemi të befashuar që ende nga institucionet e vendit tonë nuk kemi dëgjuar asnjë fjalë. Në vend që Donika Gërvalla të dalë dhe të japë një deklaratë për një padrejtësi që është bërë ndaj ish-krerëve të UÇK-së, ajo sot hesht. Ne e dimë që Donika Gërvalla ka dërguar dokumentacione në Hagë, ne e dimë që Liburn Aliu ka folur në Kuvend. Ne i bëjmë thirrje Albin Kurtit që t'i përjashtojë nga qeveria këta njerëz. Njerëzit që bashkëpunojnë me armikun janë armiq të vendit dhe kombit tim dhe nuk i dëshirojmë në mesin tonë. Ne çlirimtarët e vendit nuk jemi kundër asnjë qeverie, por jemi kundër atyre njerëzve që heshtin, gëzohen për dënimin e tyre. Unë befashohem nga Albin Kurti se qysh e mban një njeri që ende nuk e foli asnjë fjalë për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Një njeri si Donika Gërvalla, që ende nuk ka kërkuar falje para qytetarëve të Kosovës dhe dëshmorëve. Ne dimë të falim, por kërkojmë sqarim nga ajo dhe Liburn Aliu se ku i morën ato informata. Kush janë ata që i kanë vrarë ata njerëz", tha ai.

Lexo edhe:

TË GJITHA



Kryeveterani i UÇK-së kërkon dorëheqjen e Donika Gërvallës: Bashkëpunon me Vuçiç

14:27 : 18/09/2026



Euro arrin minimum të ri historik pranë 91.5 lekëve

14:25 : 18/09/2026



"Më përdh*nonte në sy të djalit", rrëfimi rrëqethës i gruas që denoncoi dhunën nga daja i Zegjine Çaushtit

14:10 : 18/09/2026



Gjykata e Tiranës lë në burg Eno Agasin, i kalon dosjen SPAK

14:06 : 18/09/2026



Aksident në aksin Elbasan-Peqin/ Makina përplasat me barrierat, plagoset një grua dhe një fëmijë

13:50 : 18/09/2026



Mijëra njerëz protestojnë në Prishtinë kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së për krime lufte

13:45 : 18/09/2026



Turqia miraton marrëveshje bashkëpunimi me Brazilin në industrinë e mbrojtjes

13:42 : 18/09/2026

Mijëra njerëz protestojnë në Prishtinë kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së për krime lufte

Shkuan në Hagë në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së, 50 veteranët mbërrijnë në Portin e Durrësit

Me pankartat në duar “Luftuam për liri”, “Ju paralajmërojmë, padrejtësinë nuk e pranojmë” dhe flamuj kombëtarë dhe të UÇK-së, qytetarët kërkuar drejtësi për ish-krerët e UÇK-së.

Etiketa: kosove protesta uck Vucic

Lajme të lidhura



Mijëra njerëz protestojnë në Prishtinë kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së për krime lufte

13:45 : 18/09/2026



Shkuan në Hagë në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së, 50 veteranët mbërrijnë në Portin e Durrësit

10:53 : 18/09/2026




Ç'mund të ndodhë me 7 figurat e UÇK-së që u përmendën në aktgjykimin e 16 shtatorit?

09:58 : 18/09/2026



Abilekaj: Gabuam duke i parë serbët si partnerë! Vendimi Hagës na gjeti të gjithëve në faj

22:23 : 17/09/2026



Shkullaku: E dinim që Gjykata Speciale do të kishte pasoja për liderët e UÇK-së, çfarë u mor në shkëmbim?

22:01 : 17/09/2026



Sikur piktori ta ndihmonte Kosovën aq sa e mbështeti Beogradin, shqiptarët do të ishin sot më të fortë

22:00 : 17/09/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.
Na kontakto:

NA NDIQ



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.